



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.212/21
235/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi -Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Sallahu”SH.P.K- Kaçanik, si dhe OE: “Kema Company ” SH.P.K-Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: “Quality Asphalt”SH.P.K.; & “Mirusha Company”SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1 , me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Prishtinë”, më datën: 29.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHEN, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “Sallahu”SH.P.K- Kaçanik, si dhe OE: “Kema Company ” SH.P.K-Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1 , me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Prishtinë”,

II.VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1 , me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Prishtinë”,

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: “Sallahu”SH.P.K- Kaçanik, si dhe OE: “Kema Company ” SH.P.K-Lipjan, aprovohen si të bazuara , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: “Sallahu”SH.P.K- Kaçanik, si dhe OE: “Kema Company ” SH.P.K-Lipjan, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 05.03.2021 me nr. 212/21, dhe me datë 15.03.2021 me nr. 235/21 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” Lot 1 , me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 , 27 , 28 , 51 , 52 , 56 , 59 , 60 , si dhe nenin 69 , të LPP-së, te ankesa me nr. 212/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 59 , si dhe nenin 72 të LPP-së , te ankesa me nr. 235/21.
- A01 – RRUOPP-së, Janë shkelur vendimet paraprake të komisioneve vlerësuese të AK-së të cilat kanë shpallur fitues kompaninë tonë Kema Company-SH.P.K.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirm nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.03.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë: 18.03.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES : “Sallahu”SH.P.K- Kaçanik,

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtine, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës në lotin 1 pas ri vlerësimit të ofertave.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113): Fillimisht po sqarojmë se loti 1, i këtij aktiviteti të prokurimit ka qene objekt shqyrtimin në OSHP, dhe janë nxjerr dy vendime nga Paneli Shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit me kërkesën kryesore për ri vlerësim të ofertave.

-Si pretendim i përbashkët ankimore i te dy OE-ve është ngritur kundër ofertës se operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit të ofertave, kontestohen projektet e realizuara, konkretisht potencohet se anëtari i grupit të operatoreve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka përdorur aneksin 6, të dosjes së tenderit, prandaj po e trajtojmë si pretendim të përbashkët. Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie në lot 1, ka ofertuar në grup, aneksi 6 është plotësuar nga lideri për projektet e tij, përderisa anëtari i grupit ka përdorur liste të veçantë, rrjedhimisht vlerësimi ynë është se mos aplikimi i aneksit 6, përshkrimi i projekteve nuk e bënë një oferte të pa përgjegjshme. Përveç kësaj, vlera e përshkruar në listë, përkatësisht raportet e pranimit teknik të punëve dhe referencat e prezantuara në oferte e mbulojnë vlerën e kërkuar nga AK, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional.

Pretendimi tjetër ankimore i OE “Sallahu” sh.p.k, ka të bëjë me listën e punëtorëve ku potencohet se OE nuk ka ofruar nga 30 punëtorë për 3 vitet e fundit. Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie përmes ofertës ka ofruar listën e punëtorëve të deklaruar në ATK, për vitin 2019 dhe 2020, përmes dëshmisë dokumentare për punëtorët e paraqitur në administratën tatimore të Kosovës, nga AK, është kërkuar, deklarate nga OE se posedon 30 punëtorë të paraqitur në ATK, rrjedhimisht OE i rekomanduar për dhënie posedon rreth 80 punëtorë të deklaruar në ATK

Pretendimi tjetër ankimore ka të bëjë me stafin e kualifikuar konkretisht, kontestohet përvoja e punës së inxhinierit të ndërtimitarisë z. Shaban Krasniqi, ku potencohet se i njëjti nuk i ka dy vite përvojë pune duke iu referuar referencës së lëshuar nga NNP “Liridoni”. Përmes kopjes së diplomës përshkruhet se i njëjti me datën 23.12.2009, i ka përfunduar studimet dhe ka marrë titullin inxhinier i ndërtimitarisë drejtimi – konstruktiv. Përderisa në CV e prezantuar në oferte, përshkruhet se i njëjti që nga data 02.02.2010, punon si inxhinier i ndërtimit në NNSH “Top Projekt”, me detyrë të punës si menaxher i punëve ndërtimore. Është prezantuar kopja e kontratës dhe referencat përmes të cilave mbulohet kërkesa e AK-së.

Përderisa kundrejt inxhinierit tjetër kontestohet Veton Blakaj, potencohet se CV e të njëjti nuk është nënshkruar. I njëjti ka prezantuar kopjen e diplomës, CV, kopjen e kontratës dhe reference, rrjedhimisht mos nënshkrimi i CV, nuk e kualifikon një oferte si të pa përgjegjshme një operator ekonomik. Pretendimi i fundit ankimore ka të bëjë me mos identifikimin financiar. Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar qarkullimin bankar nga “NLB Banke”, rrjedhimisht qarkullimi bankar është i identifikueshëm si dhe përmes arsyetimit të fundit të vendimit të OSHP-së, është potencuar se identifikimi financiar nuk e bënë operatorin ekonomik të pa përgjegjshëm.

-Si prova shkresore se bashku me raport gjeneroi kopjet e listës së punëtorëve (ATK), stafit CV, diploma, lista e kontratave etj.

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Kema Company ” SH.P.K-
Lipjan,**

Pretendim tjetër ankimore kundrejt këtij OE ka të bëjë me arsyetimin e eliminimit. Në përmes raportëve paraprahe e kemi trajtuar këtë pretendim, kemi dhënë sqarimet tona ku kemi potencuar se sipas kopjes së diplomës znj Ajdini, studimet i ka përfunduar me datën 12 prill 2018, ku ka marrë titullin Bachelor i ndërtimtarisë, programi studimor –Konstruktiv dhe si dëshmi ishte kërkuar nga AK, CV, diplome, kontratat e punës dhe referenca për punët e mëparshme.

Kundrejt znj Ajdini, ishte prezantuar kopja e diplomës, kontratës dhe CV, por jo edhe reference.

Paneli shqyrtues këtë qeshje e ka gjykuar përmes dy vendimeve. Përmes arsyetimit të vendimit të parë është kërkuar të bëhet ri vlerësim i ofertave duke e obliguar AK-në që të kërkojë sqarime shtese konform nenit 59.2 dhe 72, të LPP-se. AK, përgjatë ri vlerësimit kishte kërkuar sqarim shtesë dhe sqarimet e ofruara lidhur me referencën i kishte trajtuar si të mirëqena dhe ishte konsideruar nga AK se ishte plotësuar kërkesa, rrjedhimisht parashtruesi i ankesës ishte rekomanduar për dhënie të kontratës. Megjithatë përmes arsyetimit të vendimit tjetër atë me nr. 1122-1165/20, paneli shqyrtues përveç tjerash ka konstatuar se OE tani ankues “Kema Company” ka ofertuar me pajisje teknike të “Eskavatori” sh.p.k, sipas marrëveshjes së datës 13.07.2020, ku të njëjtit OE i është dhënë kontrata në lotin 4, dhe se për të gjitha lotët janë kërkuar pajisje teknike. Po ashtu është konstatuar se AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë të ofertave kundrejt kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit dhe vlerësimi nuk është bërë sipas nenit 59, të LPP-se.

Tani për si vlerësimi të ofertave AK – Komuna Prishtinë përmes Vendimit kundrejt Kërkesës për ri shqyrtim, ka potencuar se parashtruesi i ankesës, dheshmit e ofruara nga trusti për inxhinierën znj. Saxhede Ajdini, tregojnë se përvoja e punës për inxhinierën është bërë pas datës së dorëzimit të ofertave dhe se pranimi i një dëshmie të tillë konsiderohet si plotësim i dokumentacionit dhe është në kundërshtim me LPP.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve “Sallahu”sh.p.k dhe OE Kema Company”sh.p.k, të aprovohet si pjesërisht a bazuar, rrjedhimisht ti lejohet AK-se të procedoj tutje me lotin 1, të aktivitetit të prokurimit sipas dispozitave të LPP-se.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.03.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 18.03.2021, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “Sallahu”SH.P.K- Kaçanik , me datë: 22.03.2021, me anë të parashtrësës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar,

Me datë 18.03.2021 kemi pranuar Raportin e ekspertit shqyrtues të prokurimit ,lidhur me Ankesën nr. 212/21 të datës 05.03.2021, për aktivitetin e prokurimit; " Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse" me nr. të prokurimit 616-20-2390-5-1-1 (Lot 1) të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Prishtinë, ndaj të cilëve kemi parashtruar ankesë sipas dispozitave ligjore, dhe bazuar në kërkesën nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për përgjigje lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues , Kompania Sallahu Sh.p.k deklaron; Qëndrojmë pranë të gjitha pikave të Ankesës me nr. 212/21 të datës 05.03.2021. Sa i përket ekspertizës së pranuar, e njëjta për ne është kontradiktore, sepse në të rekomandohet që paneli shqyrtuesi OSHP të aprovojë pjesërisht të bazuara ankesat e OE, dhe të njëjtën kohë AK të vazhdojë me procedurën e prokurimit. Nuk pajtohem me trajtimin e pikave ankimore të bëra nga eksperti shqyrtues, pasi që pretendimet tona janë të drejtuara pikërisht në mos respektimin e nenit 59 të LPP -se dhe RRUOPP-së nga AI<, për faktin se operatori i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

1. Sa i përket pretendimit të parë ankimor që ka qenë kontestimi i listës së kontratave të realizuara, përkatësisht Ankesa 6.

Pasi që OE i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar ofertën në konzorcium, lideri i grupit ka plotësuar Ankesa 6 dhe nga të dhënat e paraqitura në këtë listë, vlera e projekteve të realizuara për 3 vitet e fundit ka vlerën 360,171.54€. Ndërsa kërkesa nga AK ka qenë kontrata të realizuara në 3 vitet e fundit në vlerë prej 1.6 milionë euro. Eksperti shqyrtues i është referuar një liste të veçantë të prezantuar nga grupi i konzorciumit. Kjo listë nuk është konform kërkesave të AK, dhe përveç të tjerash është listë e cila nuk i përmban të dhënat e kërkuara nga AI<, pra me të dhëna të mangëta.

Njësoj kishte vepruar edhe një OE tjetër në një aktivitet tjetër të prokurimit, dhe po i njëjti ekspert shqyrtues e kishte kontestuar këtë listë. Po e citojmë deklarin e tij të dhënë në ekspertizën nr. : 123 134/21. " Sipas dëshmisë dokumentare nga AK është kërkuar që përveç të tjerash OE të përshkruajnë datën e përfundimit të projektit, një gjë e tillë nuk është bërë nga OE rekomanduar për kontratë, rrjedhimisht nuk dihet nëse projektet e përshkruara janë realizuar për periudhën kohore siç është kërkuar nga AK. Pra lidhur me të njëjtën çështje nga eksperti kemi konstatime të ndryshme, që paraqet konfuzion për ne si operatorë ekonomik. (Për çështje korrektësie i gjeni të bashkangjitura listat e kontratave ku vërtetohet se janë plotësuar në formë të njëjtë nga operatorët ekonomik.) 2.Sa i përket pretendimit të dytë ankimor, gjegjësisht lidhur me kërkesën e AK që operatorët ekonomik të ofrojnë dëshmi për min. 30 punëtorë të paraqitur në ATK për 3 vitet e fundit.

Edhe eksperti shqyrtues e konstaton se listat e pagave janë ofruar vetëm për vitin 2019 ~ 2020 (ku viti 2020 nuk hynë fare brenda kësaj kërkeje, pasi që ofertat janë dorëzuar në vitin 2020)

Pra rrjedhimisht, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për vitin 2017 dhe 2018 që posedon min. 30 punëtorë, dhe ky është fakt i pa kontestueshëm. 3.Në pikën ankimore nr.3 ku kontestohet përvoja e punës së ing. Shaban Krasniqi. Çështja kontestuese ka qene përkatësisht CV e inxhinierit, e cila si e tillë e obligon AK të veprojë sipas RRUOPP-së : "Kur CV e dorëzuar nuk i përmbushë kërkesat- refuzo tenderin pa kërkuar sqarim " Pra lidhur me përvojën e punës, ku nga CV e

prezantuar, i njëjti rezultoi se nuk ka min.2 vite përvojë pune. Referenca e prezantuar nga NTP Liridoni, po e ri theksojë është përvojë e punës para diplomimit të njëjtit. Kontrata e punës e prezantuar me Mirusha Company, gjegjësisht përvoja me Mirusha Company nuk është e prezantuar fare në CV e nënshkruar nga inxhinieri, dhe ka një mos përputhje me të dhënat e prezantuara nga CV.

Ndër të tjera kontrata e prezantuar është e lidhur në vitin 2019 që prapë nënkupton se nuk është përmbushur përvoja prej dy viteve. Kërkojmë nga paneli shqyrtues që ta shqyrtojë ankesën tonë, dhe faktet e bashkangjitura, në përputhje edhe me rekomandimin e ekspertit mbi aprovimin e pjesërisht të ankesave, ta aprovojë si të bazuar ankesën tonë, dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim për LOT 1. Me respekt.

AK në pozicionin 1, të kërkesës së pikës 9.1, të FDT-se, ka kërkuar: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlera prej 2.000.000.00 Euro në 3 (tri) vitet fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë

OE, ka prezantuar listën e projekteve si të realizuara në mesin e tyre janë përshkruar vetëm katër (4) projekte në të përfunduara në vitin 2018 dhe dy (2) në vitin 2017. Sipas dëshmisë dokumentare nga AI< është kërkuar që përveç tjerash OE-të të përshkruajnë datën e përfundimit të projektit, një gjë e tillë nuk është bërë nga OE i rekomanduar për dhënie pas ri-vlerësimit të ofertave, rrjedhimisht nuk dihet nëse projektet e përshkruara janë realizuar në periudhën kohore siç është kërkuar nga AI< - Komuna Pejë.

-Si prova se bashku me raport gjeneroi kopjen e listës së projekteve.

Pretendimet tjera kanë të bëjnë kundër pajisjeve të prezantuara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës pas ri-vlerësimit të ofertave. Kontestohet kapaciteti i ekskavatorit me zinxhirë, cilindrat dhe disa pajisje tjera,

-Sipas ofertës së të njëjtit OE, rezultoi që nuk ka prezantuar dëshmi kontratë sipas kërkesës së AK-se, Lidhur me kapacitetin e të gjitha pajisjeve teknike. Përveç kësaj o njëjti OE, në DUD, doganor të caktuar ka përshkruar kapacitetin e pikës me shkrim dore. Sa i përket arsyeve të eliminimit të dy parashtruesve të ankesave në, në raportin paraprak sipas pretendimeve ankimore ka rezultuar që të dy operatorët ekonomik nuk i kanë plotësuar në tërësi kërkesat, e aplikuar në dosjet e tenderit dhe në njoftim për kontratë. Shembull OE "Sallahu" sh.p.k, ka prezantuar Certificate Trajnimi, nga AQSCERT, në emër të z. Ilmi H. Fetaj, megjithatë AK, ka kërkuar Certificate për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale Përdorur OE "Joos Krasniqi" atëherë i rekomanduar për dhënie, konkretisht menaxheri i projektit nuk e plotësoi kërkesën e AK-se dhe disa nga pajisjet teknike nuk i mbulonin kërkesat e dosjes së tenderit. Këto të gjetura kundërshtojë parashtruesve të ankesave janë gjykuar dhe konstatuar edhe me vendimin paraprak me nr.

LISTA E PROJEKTEVE

Kontratat nga lëmia e infrastrukturës rrugore të kryera gjatë 3 viteve të fundit:

Emri i projektit	Vlera e puneve te kryera	Autoriteti kontraktues	Dëshmia e ofruar	Perfundimi dhe pranimi i punimeve ne vitin
Zgjerimi i rrugës Nacionale M9, Segmenti: Gjurgjiçë - Kijevë, Sektori "D"-Lot.L=2.75	6.174.846.32	Ministria e Infrastruktures	Referenca	2018
Rehabilitimi i rrugeve lokale ne fshtrat e Rugoves	765.320.35	Ministria e Infrastruktures	Referenca	2017
Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale për vitin 2016 / 2017 - Rajoni i Pejës "2"	777.582.08	Ministria e Infrastruktures	Raporti i pranimit	2017
Asfaltimi i rruges Istog-Cerrece, 2017/2018	238.898.61	Komuna Istog	Referenca	2018
Asfaltimi i rruges Dubrave ne istog, Kontrate dy vjeqare 2017/2018	121.214.85	Komuna Istog	Referenca	2018
Asfaltimi i rruges Banje-Baice, 2017	86.675.43	Komuna Istog	Referenca	2018
Zgjerimi i rruges M-9, Arllat Gjergjice	8.496.751.32	Ministria e Infrastruktures	Referenca	2013
Asfaltimi i rruges "Jakup Ferri" Istog	35.931.30	Komuna Istog	Referenca	2016
Asfaltimi i rruges Banaje Corrolluke, Loti I	34.263.23	Komuna Istog	Referenca	2016
Asfaltimi i rruges "Gjergj Fishta" Banje Loti II	20.414.48	Komuna Istog	Referenca	2016
Asfaltimi rruges "Binak Periqi Loti I	34.269.23	Komuna Istog	Referenca	2016
Asfaltimi rruges "Binak Periqi Loti II	8.906.60	Komuna Istog	Referenca	2016
Asfaltimi i rruges "Kongresi i Manastirit"	74.333.40	Komuna Istog	Referenca	2016
Asfaltimi i dy platove dhe hyrjes se QKMF-se	24.825.47	Komuna Istog	Referenca	2016 <i>ff/f</i>

Lista e projekteve te realizuara ne tri vitet e fundit

Nr.	Projekti te realizuara	Vlera e projektit nëë	Data nënshkrimit kontratës	o Viti i përfundimit	Vendi i ckozokutimit te punimeve	i investitorit	Pozicioni ynë
1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Piluzhinë	269.619.30	08.06.2015	2016	Piluzhinë	K.K. Skenderaj	Kontraktor
2	Asfaltimi i rrugëve në Qytet	49.512.52	10.06.2016	2016	Klinë	K.K. Klinë	Kontraktor
3	Asfaltimi i rrugëve në Duqajevë	23.988.95	21.06.2016	2016	Klinë	K.K. Klinë	Kontraktor
4	Asfaltimi i rrugëve në Tomogonë, Drngobil dhe asfaltimi i rrugës nga Palestra deri në lagjen Pallanka	193.094.50	16.08.2016	2016	Mallshëvë	K.K. Mallshëvë	Kontraktor
5	Asfaltimi i rrugëve Mëc Soko dhe Kavendi i Lezhës	19.222.20	06.09.2016	2016	Klinë	K.K. Klinë	Kontraktor
6	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Qallapok dhe në fshatin Kryslie	43.150.00	05.09.2016	2016	Pejë	K.K. Pejë	Kontraktor
7	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ramoc-Shupol	139.736.95	20.09.2016	2017	Klinë	MI	Kontraktor
8	Asfaltimi i rrugës në Izbicë, lagja Alija Mehmuti, Bajraku	815.240.40	28.08.2015	2017	Izbicë	K.K. Skondoraj	Kontraktor
9	Asfaltimi i rrugës Polluzhë-Shtuticë- Dashec	410.349.09	12.05.2017	2017	Polluzhë-Shtuticë-Dashec	K.K. Drenas	Kontraktor
10	Asfaltimi i rrugës në Ramoc	13.333.00	22.11.2016	2017	Ramoc	K.K. Klinë	Kontraktor
11	Asfaltimi i rrugës në Jashanicë lagja Myrtaj	66.981.4	10.05.2017	2017	Jashanicë	K.K. Klinë	Kontraktor
12	Asfaltimi i rrugës në Jashanicë lagja Mulaj, Rukolli dhe Gashl	79.999.99	11.07.2017	2017	Jashanicë	K.K. Klinë	Kontraktor
13	Asfaltimi i rrugëve në Dolq- Segmenti 3 dhe 4	28.294.00	05.10.2017	2017	Dolq	K.K. Klinë	Kontraktor
14	Asfaltimi i rrugëve në Delq- Segmenti 1 dhe 2	54.870.80	11.08.2017	2017	Delq	K.K. Klinë	Kontraktor

15	ASFALTIMI I RRUGES PAVLAN - NAKULL	112,569.20	18.05.2017	2017	Pavlan-Nakull	K.K.PoJë	Kontraktor
16	ASFALTIMI I RRUGES RASHIQ- BROLIQ	192,777.35	18.05.2017	2017	Rashiq-Broliq	K.K.PoJë	Kontraktor
17	ASFALTIMI I RRUGES NE FSHATIN POLLUZHE-SHTUTICE-DASHEC	22,188.69	17.11.2017	2017	Polluzho-Shtutice-Dashec	K.K.Drenas	Kontraktor
18	ASFALTIMI I RRUGES NE FSHATIN IZBICE.KK SKENDERAJ	80,926.70	01.12.2017	2017	Izbice	K.K.Skenderaj	Kontraktor
19	ASFALTIMI I RRUGES NE FSHATIN POTERQI I EPERM	258,804.04	02.07.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
20	ASFALTIMI I RRUGES PERQEVE- SHERKE	311,676.39	18.07.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
21	ASFALTIMI I RRUGES NE POTERQI I EPERM - ANEKS KONTRATE	25,379.20	10.09.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
22	ASFALTIMI I RRUGES NE BASHKEFINANCIM	105,561.60	04.10.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
23	ASFALTIMI I RRUGES RRUGA NEZAJMTE SHKOLLA DHE RRUGA NE PERIFERI TE QYTETIT LAGJA PALUCAJ	50,958.50	15.10.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
24	ASFALTIMI I RRUGES PERQEVE- SHERKE - ANEKS KONTRATE	30,942.20	16.11.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
25	ASFALTIMI I RRUGES NE BUDISALC DHE NE DOLLCE	51,955.95	29.11.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
26	ASFALTIMI I RRUGES BUDISALC - ANEKS KONTRATE	3,837.60	18.12.2018	2018	Kllnë	K.K.Kllnë	Kontraktor
	Lista e projekteve te realizuara ne perafshim te 2016-2017-2018:	3,454,970.39					

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik

12.

Nen kontraktimet

Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi për min. 30 punëtor te paraqitur ne administratën tatimore ne tre vitet e fundit për - vetëm për LOT 1.

3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshëm për realizimin e projektit.Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

4. OE duhet te ketë Baze për Prodhimin e asfaltit ne Pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt - për te gjitha Lotet.

5.OE Duhet te ketë Gurëthyes te licencuar ne Pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr - Për të gjitha Lotet

6.OE Duhet te ketë Baze për prodhimin e Betonit ne Pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton Për të gjitha Lotet.

3. Deklaratat unike dërgoi fatura e blerjes për regjistrohen, ndërsa regjistrohen duhet dëshmi qarkullimit. Ne rastet kur për shfrytëzimin e automjete dorëzoj edhe marrëveshjen automjeteve.

norë ose kont automjetet qe automjetet ar me Libreza: për OE ka mare automjete, OE duhet për shfrytëzim

4. Kopja e Licencës e vlefshme Agjencioni për miniera dhe kur OE ka marrëveshje për te dorëzoj edhe kopjen <furnizim. me e lëshuar minerale. Ne furnizim, OE di marrëveshjes

5. Kopja e Licencës e vlefshme Agjencinë për miniera dhe kur OE ka marrëveshje për te dorëzoj edhe kopjen furnizim. vlefshme e lëshuar minerale. Ne furnizim, OE marrëveshjes

6.OE Duhet te këtë Bazë^ Betonit ne Pronësi apo furnizim me beton Për të gj për prodhimi marrëveshje gjitha Lotet

a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës

b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe

d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

e. Secili anëtar i Grupit te Operatoreve Ekonomik duhet te regjistrohet ne platformën elektronike

a) një deklaratë ku deklarojnë nën kontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatëse të prokurimit, dhe

b) Të gjithë ko traktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.

Operatori Ekonomik: “Kema Company”SH.P.K-Lipjan , me datë: 22.03.2021, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar ne përmes disa scarimeve mendojmë te ju kthejmë një përgjigje ne lidhje me mendimin e Ekspertit Shqyrtues me nr: 212 235/21. Nr. i prokurimit: 616-20-2390-5-1-1 Nr. i brendshëm: 616 20 039 511 Titulli: Ndërtimi i rrugëve ne pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse Eksperti shqyrtues thotë: Janë kërko: Diploma, Kontrata, CV dhe Referenca - SIPAS DOSJES SE TENDERIT = NUK JANE KERKU REFERENCA. Për inxhinieret e kërkuar duhet dëshmuar CV- a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi për menaxher i projektit, ndërsa për punëtoret e paraqitur ne administratën tatimore te Kosovës, deklarate nga OE se posedon 30 punëtor te paraqitur ne ATK. JANE KERKU REFERENCA VETEM PER MENAXHERIN E PROJEKTIT !! Kriter ne Dosje Tenderi ka qen: Diploma me 2 vite përvojë pune, Kontrata dhe CV - TE CILAT I KEMI DORZU. o Dy (2) Inxhinier

ose bacheloret ndërtimtarisë (konstrukti ose infrastrukture) me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotet. o Një (1) Eksperti shqyrtues thotë: AK nuk është bind për sqarimet shtesë të cilat janë kërkuar (TRUST ose ATK) për bsc. Saxhide Ajdini me arsyetimin se janë paguar pas datës së ofertimit. KETO KUSHTE DHE KRITERE NUK JANE NE DOSJE TENDERI, DHE NUK MUNDEN ME NA ELIMINU PER KRITERE QE NUK JANE NE DOSJE.

Eksperti shqyrtues thotë: OE Kema Company ka marrëveshje për mjete me OE Eskavatori për të cilën pretendohet se është shpërblye me kontratë në Lotin 4 - Nuk e ka të nënshkruar Lotin 4 dhe asnjë lot tjetër OE Eskavatori thjesht ka qen pretendim i rrejshëm i Quality Asphalt, me poshtë gjeni kontratën e nënshkruar:

PJESAI EKONTRATËS: KONTRATA

Komuna e Prishtinës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; Dhe Bujar Shabani ' B.J - N.P.SH "Bageri", (në vazhdim "Kontraktuesi"), me adresë: Magjistralja Gaçkë - Ferizaj, me numër unik identifikues të biznesit 010644197, përfaqësuar nga Bujar Shabani-drejtor, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara me poshtë:

Titull: Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse - loti 4

Numri	IG16	2	0	0	3	9	5	1	1
-------	------	---	---	---	---	---	---	---	---

Në 1 Lënda

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit për: Ndërtimi i rrugës në lagjen Isufi - Keqekollë sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate

Në 2 Çmimi

Çmimi total i punëve duhet, të jetë: 117,164.07 C; (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër euro o zero shtatë Euro cent).

Eksperti shqyrtues thotë: OE Quality Asphalt nuk mund të vlerësohet si i pa përgjegjshëm edhe pse nuk e ka plotësuar kriterin e dosjes së tenderit. Quality asphalt nuk e plotëson vlerën e kontratave të kërkuara sipas dosjes së tenderit ndërsa OE partner i saj nuk e ka të plotësuar Aneksin 6 që është kriteri i dosjes së tenderit.

Si është e mundur që një Oferte e OE: Quality Asphalt të mos jetë e pa përgjegjshme kur nuk e ka të plotësuar një kriter obligativ sipas dosjes së tenderit dhe nuk plotëson kapacitetin teknik dhe profesional dhe dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kësaj dosje:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale

prej Loto 1.1.600.000,00 euro

Loto 2.100.000,00 euro Loto

3. 200.000,00 euro Loto 4.

200.000,00 euro Loto 5.

300.000,00 euro Loto 6.

200.000,00 euro Loto 7.

550.000,00 euro Loto 8.

150.000,00 euro.

Dëshmia e kërkuar Dokumentare

Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote, shuma më e lartë e vlerës së kontratave të realizuara që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE. Shembull Nëse OE vendos që të konkurrojë në Lot 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e punëve të realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE është 1,600,000.00 euro. nëse OE vendos që të konkurroj në Lot 2 dhe 3, atëherë kërkesa minimale e punëve të realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE është 1,600,000.00 euro Nëse OE vendos që të konkurroj në Lot 2 dhe 3 , atëherë kërkesa minimale e punëve të realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE është 200.000.00 euro.

Ne asnjë nga mendimet e Ekspertit Shqyrtues nuk mundemi të pajtohemi kur posedojmë të gjitha këto dëshmi nga vet Dosja e Tenderit për të cilën po Ankohemi.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 29.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES : “Sallahu”SH.P.K- Kaçanik,

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113): Fillimisht po sqarojmë se loti 1, i këtij aktiviteti të prokurimit ka qene objekt shqyrtimin ne OSHP, dhe janë nxjerr dy vendime nga Paneli Shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit me kërkesën kryesore për ri vlerësim të ofertave.

-Si pretendim i përbashkët ankimore i të dy OE-ve është ngritur kundër ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit të ofertave, kontestohen projektet e realizuara, konkretisht potencohet se anëtari i grupit të operatoreve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka përdorur aneksin 6, të dosjes së tenderit, prandaj paneli shqyrtues e trajton si pretendim të përbashkët. Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie në lot 1, ka ofertuar në grup, aneksi 6 është plotësuar nga lideri për projektet e tija, përderisa anëtari i grupit ka përdorur liste të veçantë. Sipas Panelit Shqyrtues lista e plotësuar nga anëtari i grupit përmban të gjitha elementet të cilat kërkohen për vlerësim të aftësisë teknike dhe profesionale, respektivisht për vlerësim të vlerës së realizuar të kontratave të natyrës së ngjashme dhe rrjedhimisht sipas Panelit shqyrtues mos plotësimi i aneksit 6 por dorëzimi i një liste tjetër me përshkrimin e projekteve nuk e bënë një ofertë të pa përgjegjshme. Përveç kësaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se vlerat e përshkruara në listë, përkatësisht raportet e pranimit teknik të punëve dhe referencat e prezantuara në ofertë e mbulojnë vlerën e kërkuar nga AK, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional. **Paneli Shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar.**

Pretendimi tjetër ankimore i OE "Sallahu" sh.p.k, ka të bëjë me listën e punëtorëve ku potencohet se OE nuk ka ofruar nga 30 punëtorë për 3 vitet e fundit. Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie përmes ofertës ka ofruar listën e punëtorëve të deklaruar në ATK, për vitin 2019 dhe 2020, përmes dëshmisë dokumentare për punëtorët e paraqitur në administratën tatimore të Kosovës, nga AK, është kërkuar, deklarate nga OE se posedon 30 punëtorë të paraqitur në ATK, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për dhënie posedon rreth 80 punëtorë të deklaruar në ATK. **Paneli Shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar.**

Pretendimi tjetër ankimore ka të bëjë me stafin e kualifikuar konkretisht, kontestohet përvoja e punës së inxhinierit të ndërtimtarisë z. Shaban Krasniqi, ku potencohet se i njëjti nuk i ka dy vite përvojë pune duke iu referuar referencës së lëshuar nga NNP "Liridoni". Përmes kopjes së diplomës përshkruhet se i njëjti me datën 23.12.2009, i ka përfunduar studimet dhe ka marrë titullin inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi – konstruktiv. Përderisa në CV e prezantuar në ofertë, përshkruhet se i njëjti që nga data 02.02.2010, punon si inxhinier i ndërtimit në NNSH "Top Projekt", me detyra të punës si menaxher i punëve ndërtimore. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se është prezantuar kopja e kontratës dhe referencat përmes të cilave mbulohet kërkesa e AK-së. **Paneli Shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar.**

Përderisa kundrejt inxhinierit tjetër kontestohet Veton Blakaj, potencohet se CV e të njëjti nuk është nënshkruar. I njëjti ka prezantuar kopjen e diplomës, CV, kopjen e kontratës dhe reference, rrjedhimisht mos nënshkrimi i CV, nuk e kualifikon një ofertë si të pa përgjegjshme një operator ekonomik. Paneli

Shqyrtues konstaton se nënshkrimi i CV nga vete inxhinieri nuk ka qene kërkesë e përcaktuar në DT , dhe rrjedhimisht kjo pike ankimore është e pabazuar.

Pretendimi i fundit ankimore ka të bëjë me mos identifikimin financiar. Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar qarkullimin bankar nga “NLB Banke”, rrjedhimisht qarkullimi bankar është i identifikueshëm si dhe përmes arsytimit të fundit të vendimit të OSHP-se, është potencuar se identifikimi financiar nuk e bën operatorin ekonomik të pa përgjegjshëm. Për më tepër identifikimin financiar është formular në pjesën B të Dosjes së Tenderit, që do të thotë se është pjesë e kontratës. Pra është formular i cili duhet të plotësohet para nënshkrimit të kontratës, pra nuk është kërkesë e përcaktuar në FTD. **Paneli Shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.**

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES : “KEMA”SH.P.K- Kaçanik,

Pretendim tjetër ankimore kundrejt këtij OE ka të bëjë me arsytimin e eliminimit. Në përmes raporteve paraprake e kemi trajtuar këtë pretendim, kemi dhënë sqarimet tona ku kemi potencuar se sipas kopjes së diplomës znj Ajdini, studimet i ka përfunduar me datën 12 prill 2018, ku ka marrë titullin Bachelor i ndërtimtarisë, programi studimor –Konstruktiv dhe si dëshmi ishte kërkuar nga AK, CV, diplome, kontratat e punës dhe referenca për punët e mëparshme.

Kundrejt znj Ajdini, ishte prezantuar kopja e diplomës, kontratës dhe CV, por jo edhe reference.

Paneli shqyrtues këtë qeshje e ka gjykuar përmes dy vendimeve. Përmes arsytimit të vendimit të parë është kërkuar të bëhet ri vlerësim i ofertave duke e obliguar AK-në që të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72, të LPP-se. AK, përgjatë ri vlerësimit kishte kërkuar sqarim shtesë dhe sqarimet e ofruara lidhur me referencën i kishte trajtuar si të mirëqena dhe ishte konsideruar nga AK se ishte plotësuar kërkesa, rrjedhimisht parashtruesi i ankesës ishte rekomanduar për dhënie të kontratës. Po ashtu është konstatuar se AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë të ofertave kundrejt kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit dhe vlerësimi nuk është bërë sipas nenit 59, të LPP-se.

Tani pas rivlerësimit të ofertave AK – Komuna Prishtinë përmes Vendimit kundrejt Kërkesës për ri shqyrtim, ka potencuar se parashtruesi i ankesës, dëshmit e ofruara nga trusti për inxhinieren znj. Saxhede Ajdini, tregojnë se përvoja e punës për inxhinieren është bërë pas datës së dorëzimit të ofertave dhe se pranimi i një dëshmie të tillë konsiderohet si plotësim i dokumentacionit dhe është në kundërshtim me LPP.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me

çmim me te lire nga te gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - "KK-Prishtinë",
- 1x1 OE- : "Sallahu"SH.P.K- Kaçanik ,
- 1x1 OE: "Kema Company"SH.P.K-Lipjan ,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.